



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 10, datë 14.01.2021**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANCELARËVE NË DETYRË NË**  
**GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 dhe 97, pika 1 shkronja “a”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 55 dhe 83, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 6 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424 , datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë.
2. Caktimin e relatorit për secilin kancelar në detyrë, si më poshtë:
  1. Për znj. Elka Dajçi - relator z. Medi Bici
  2. Për z. Saimir Shyti - relator znj. Fatmira Luli
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kancelarëve në detyrë të përfshirë në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**